

**Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë**  
**MISIONI NË KOSOVË**

**Raporti 04/2007 i Shtyllës së III-të (OSBE)**  
**Mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës**  
**24 shtator 2007 – 30 nëntor 2007**

**Titujt kryesor**

- Kuvendi miraton në parim projektligjet për përdorimin e simboleve shtetërore, projektligjin për ministrinë e punëve të jashtme dhe projektligjin për imunitetin e misioneve diplomatike dhe konsullare në Kosovë dhe praninë ushtarake ndërkombëtare
- Kuvendi miraton në parim projektligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve të Kuvendit
- Kuvendi vendos të vazhdojë punën gjatë fushatës zgjedhore
- Kuvendi miraton një amendament në Rregulloren e Punës
- Kuvendi i kthen pesë projektligje Qeverisë për ripunim

**1. Sfond**

Raporti i pesëdhjetekatërt i monitorimit është hartuar në përputhje me pikëpamjet referuese të Shtyllës së tretë të UNMIK-ut për themelimin e institucioneve (OSBE) dhe monitorimin e Kuvendit të Kosovës prej datës 26 nëntor 2002 dhe bazohet në Rregulloren e re të punës, të miratuar në fund të seancës plenare më 20 maj 2005 dhe të reviduar në seancën e mbajtur më 1-2 qershor 2006.

Gjatë periudhës raportuese, Kuvendi ka mbajtur tri seanca plenare të rregullta, më 27 shtator, 18 tetor dhe 30 tetor/2 nëntor si dhe dy mbledhje të rregullta të Kryesisë, më 11 tetor dhe 25 tetor. Dhjetë komisionet dhe nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, peticione dhe ankesa publike kanë mbajtur mbledhje gjatë periudhës raportuese. Shtylla e III-të (OSBE) i ka monitoruar seancat plenare dhe mbledhjet e Kryesisë, si dhe 28 prej 40 mbledhjeve të komisioneve dhe dy dëgjime publike.

**2. Vështrim**

**Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 27 shtator** e kryesoi anëtari i Kryesisë z. Sabri Hamiti (LDK).

- Shtatëdhjetë e dy deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 27 shtator.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 27 shtator:
  - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje gojore
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për përdorimin e simboleve shtetërore (Projektligji është miratuar në parim me 68 vota për dhe një votë kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për inspektoratin bujqësor (Projektligji është miratuar në parim me 60 vota për dhe dy vota kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për provimin final dhe të maturës (Projektligji është miratuar në parim me 67 vota për dhe pa vota kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ministrinë e punëve të jashtme dhe shërbimin diplomatik (Projektligji është miratuar në parim me 68 vota për dhe pa vota kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misioneve diplomatike dhe konzullare dhe personelin e tyre dhe praninë ushtarake ndërkombëtare në Kosovë (Projektligji është miratuar në parim me 62 vota për dhe pa vota kundër.)

- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ndryshimin e ligjit për regjistrat e statusit civil (Projektligji është miratuar me 63 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për statusin civil (Projektligji është miratuar me 62 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për shoqëritë tregtare (Projektligji është miratuar me 63 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për vendbanimin dhe vendqëndrimin (Projektligji është miratuar me 63 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor lidhur me projektligjin për parqet kombëtare (Rekomandimi është miratuar me 36 vota për dhe 21 vota kundër. Shiko më poshtë paragrafin e dytë të pjesa “Procesi legjislativ”.)
- Shqyrtimi i rekomandimeve të propozuara në Rregulloren e Punës (Kjo pikë është shtyrë për shkak të mungesës së kuorumit.)

**Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 18 tetor** e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Bislim Hoti (IRDK).

- Shtatëdhjetë e pesë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 18 tetorit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 18 tetorit:
  - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për mbrojtjen e mjedisit (Projektligji është miratuar në parim me 64 vota për dhe tri vota kundër.)
  - Shqyrtimi i rekomandimeve të propozuara në Rregulloren e Punës (Kuvendi ka miratuar vetëm një prej tetë amandamenteve. Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Rishikimi i Rregullores së Punës”.)
  - Shqyrtimi i rekomandimeve të komisionit për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe komunikacion lidhur me komentet e UNMIK-ut në ligjin për sigurinë në trafikun rrugor (Të njëmbëdhjetë rekomandimet janë votuar një nga një dhe janë miratuar me shumicë votash për.)
  - Shqyrtimi i rekomandimeve të komisionit për shërbime publike, administratë lokale dhe media lidhur me komentet e UNMIK-ut në ligjin për ndryshimin e ligjit për kadastrin (Të katërbëdhjetë rekomandimet janë votuar një nga një dhe janë miratuar me shumicë votash për.)

**Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 30 tetor/2 nëntor** e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Naim Maloku (AAK).

- Tetëdhjetë dhe gjashtëdhjetë e shtatë deputetë ishin të pranishëm në seancë më 30 tetor, përkatësisht 2 nëntor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 30 tetor/2 nëntor:
  - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë (Kjo pikë është hequr nga rendi i ditës. Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Shmangia nga Rregullorja e Punës”.)
  - Debatimi për traktatin e miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ofruar nga Ekipi i Unitetit (Kjo pikë është hequr nga rendi i ditës. Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Shmangia nga Rregullorja e Punës”.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për hetimin parlamentar (Projektligji është miratuar në parim me 53 vota për dhe pa vota kundër.)
  - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ndryshimin e ligjit Nr. 2003/11 për rrugët (Projektligji është miratuar me 65 vota për dhe pa vota kundër.)
  - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve të Kuvendit

- (Projektligji është miratuar me 65 vota për dhe gjashtë vota kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për parandalimin e konfliktit gjatë ushtrimit të funksionit publik  
(Projektligji është miratuar me 56 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për barnat narkotike, sunstancat psikotrope dhe prekursorët  
(Projektligji është miratuar me 63 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i rekomandimit të komisionit për arsim, shkencë, teknologji, kulturë rini dhe sport lidhur me projektligjin për arsimin privat  
(Rekomandimi është miratuar me 54 vota për dhe një votë kundër.)
- Shqyrtimi i rekomandimit të komisionit për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale lidhur me projektligjin për punë, projektligjin për grevat dhe projektligjin për lirinë e bashkimit në sindikata  
(Rekomandimi është miratuar me 53 vota për dhe një votë kundër.)
- Shqyrtimi i rekomandimit të komisionit për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me emërimin e Avokatit të Popullit  
(Kjo pikë është hequr nga rendi i ditës. Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Shmangia nga Rregullorja e Punës”.)
- Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për arsim, shkencë, teknologji, kulturë rini dhe sport lidhur me emërimin e anëtarëve të Këshillit për Trashëgimi Kulturor  
(Rekomandimi është miratuar me 52 vota për dhe katër vota kundër.)

### 3. Punimet dhe praktikat parlamentare në seancat e Kuvendit

#### Rendi i ditës

- Në fillim të seancës plenare të 18 tetorit z. Nait Hasani (PDK) kërkoi fjalën për të propozuar një ndryshim të rendit të ditës. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se propozimi për ndryshimin e rendit të ditës duhet të dorëzohet me shkrim në pajtim me rregullën 23 dhe jo të paraqitet gojarisht ashtu siç dëshironte z. Hasani. Megjithatë, z. Hasani insistoi se kishte të drejtë të propozojë gojarisht ndryshimin në rendin e ditës dhe kërkoi që propozimi i tij të hedhet në votim. Kryetari i Kuvendit e lexoi me zë rregullën 23.2 dhe e përsëriti se propozimi për ndryshimin e rendit të ditës të seancës plenare duhet të dorëzohet me shkrim, dhe vazhdoi me pikën e radhës të rendit të ditës pa e lejuar z. Hasani që ta bëjë propozimin e tij gojarisht. Në po atë kohë z. Ilmi Ahmeti (LDK) poashtu kërkoi fjalën lidhur me rendin e ditës, por Kryetari i Kuvendit nuk e lejoi të flasë me arsyetimin e njëjtë.

*Rregullat e reja 23.1-2 parashohin që “Kryesia përgatitë një propozim të rendit të ditës për seancën e radhës të Kuvendit dhe menjëherë të njëjtin e vë në dispozicion për deputetët e Kuvendit. Në fillim të seancës ky propozim rend dite do të konsiderohet i miratuar, përveç nëse një ose më shumë grupe parlamentare apo 6 deputetë i propozojnë me shkrim Kryetarit një amendament në rendin e ditës, i cili hidhet në votim.” Rregulla 23 qartë parasheh që propozimi për ndryshimin e rendin të ditës të seancës plenare duhet të dorëzohet me shkrim dhe së paku nga gjashtë deputetë e jo nga një deputet i vetëm, përndryshe rendi i ditës konsiderohet i miratuar. Andaj, nuk ka pasur shkelje dhe Kryetari i Kuvendit ka vepruar sipas rregullave që nuk u ka lejuar z. Hasani dhe z. Ahmeti të propozojnë gojarisht ndryshime në rendin e ditës së seancës plenare të 18 tetorit.*

#### Çështjet urgjente

- Në fillim të seancës plenare të 18 tetorit Kryetari i Kuvendit lajmëroi se grupi parlamentar ORA kishte dorëzuar propozimin për të debatuar për grevën e urisë të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit dhe Shkencës si çështje urgjente gjatë seancës në fjalë. Ai e hedhi në votim propozimin e ORA-s, i cili u refuzua me 36 vota kundër dhe 30 vota për. Anëtarët e grupit parlamentar ORA e lëshuan sallën plenare në shenjë proteste kundër refuzimit të propozimit të tyre.  
*Kryetari i Kuvendit e hedhi në votim propozimin e ORA’s në pajtim me rregullën 29.2 e cila parasheh që “propozimi i grupeve parlamentare për çështjet urgjente vendoset nga Kuvendi”.*

### Ripunimi i Rregullores së Punës

- Gjatë seancës plenare të 18 tetorit Kuvendi ka shqyrtuar tetë amendamente në Rregulloren e Punës të propozuara nga Kryesia. Kuvendi ka miratuar vetëm një nga tetë amendamente, që ka marrë 63 vota për dhe një votë kundër. Amendamenti i miratuar në rregullën 2 definon programin e punës së Kuvendit.<sup>1</sup> Programi i parë i punës i u është shpërndarë deputetëve para seancës plenare të 30 tetorit siç kërkohet në rregullën e ripunuar 2.

*Rregulla 58.1 parasheh që “Kryesia e shqyrton vazhdimisht Rregulloren e punës dhe kohë pas kohe mund t’i propozojë Kuvendit ndryshime, që mendon se janë të nevojshme” Andaj, Kryesia i ka propozuar amendamentet në Rregulloren e Punës në pajtim me vetë Rregulloren. Për më tepër, rregulla 58.3 parasheh që vendimi për ta ndryshuar rregulloren e punës mirret nga ana e Kuvendit me shumicën e votave të deputetëve, që domethënë se një vendim i tillë duhet të marrë së paku 61 vota për. Shtatë amendamente kanë marrë më pak se 61 vota për andaj janë refuzuar.*

*Programi i punës i parë është shtypur dhe shpërndarë deputetëve para seancës plenare të 18 tetorit në pajtim me rregullën e ripunuar 2. Veç kësaj, rregulla e ripunuar 2 kërkon që programi i punës të shpërndahet çdo ditë pune deputetëve dhe të postohet në ueb faqen e Kuvendit, gjë që akoma nuk është bërë. I rekomandohet Kuvendit që programin e punës ta postojë në faqen e tij elektronike për ta vënë në dispozicion të deputetëve, publikut dhe mediave, ashtu siç kërkohet në rregullën 2 të ripunuar.*

### Shmangia nga Rregullorja e Punës

- Më 25 tetor Kryesia së bashku me shefat e grupeve parlamentare ka caktuar seancën plenare për datën 30 tetor gjatë fushatës elektorale.<sup>2</sup> Z. Sabri Hamiti (LDK) propozoi që në fillim të seancës plenare Kuvendi duhet ta përdor rregullën 61 për të marrë vendim për shmangien nga rregulla 5.2 në mënyrë që të mbaj seancën plenare gjatë fushatës elektorale pa i thyer rregullat e procedurës. Anëtarët e tjerë të Kryesisë dhe shefat e grupeve parlamentare u pajtuan me propozimin e z. Hamiti dhe, propozimi për shmangien nga rregulla 5.2 u përfshi si pikë e parë e rendit të ditës së seancës plenare të 30 tetorit. Më pas, në fillim të seancës plenare në fjalë Kryetari i Kuvendit lajmëroi se në sallë plenare të pranishëm ishin 80 deputetë dhe e ftoi Kuvendin të votojë për t’u shmangur nga rregulla 5.2, që u miratua me 53 vota për dhe dy vota kundër. Për më tepër, shefi i grupit parlamentar të LDK-së Alush Gashi lajmëroi se ai dhe shefat e grupeve të tjera parlamentare kishin arritur marrëveshje që pyetjet për Qeverinë dhe debatet politike mos të diskutohen në Kuvend gjatë fushatës zgjedhore në mënyrë që të mos ndërhyjnë në fushatën zgjedhore. Andaj, ai propozoi që dy pika të rendit të ditës – pyetjet për Qeverinë dhe debati për traktatin e miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ofruar nga Ekipi i Unitetit – të heqen nga rendi i ditës me arsyetimin se këto çështje mund të ndërhyjnë në fushatën zgjedhore. Më tutje ai propozoi që pika e rendit të ditës për emërimin e Avokatit të Popullit poashtu të heqet nga rendi i ditës për shkak të komenteve të bëra nga OSBE-ja, Zyra e Këshillit të Evropës dhe Zyra e Komisionerit të Lartë për të drejtat e njeriut. Kryetari i Kuvendit

---

<sup>1</sup> Amendamenti i miratuar i a shton Programin e Punës së Kuvendit rregullës 2 (“Definicionet”) të Rregullores së Punës. Programi i punës definohet si “dokument zyrtar i Kuvendit i cili përmban të gjitha çështjet që presin të shqyrtohen në Kuvend. Programi i punës përgatitet, publikohet dhe shtypet para secilës seancë plenare në përputhje me këtë Rregullore, me përjashtim të seancës konstituive. Në kohën kur Kuvendi nuk ka seancë programi i punës shtypet çdo dy javë dhe iu shpërndahet deputetëve çdo ditë pune në mënyrë elektronike. Programi i punës publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit në internet. Publikimi autorizohet nga Sekretari i Kuvendit dhe vihet në dispozicion për deputetët , publikun dhe mediat. Çështjet që presin të shqyrtohen në Kuvend përfshijnë por nuk kufizohen në: mocionet e parashtruara, rezolutat, deklaratat, projektligjet, pyetjet për Qeverinë, kërkesat për interpelancë, raportet e komisioneve dhe raportet vjetore të Qeverisë, etj”.

<sup>2</sup> PSSP-ja ka vendosur që fushata zgjedhore do të fillojë të enjten më 25 tetor 2007 në mesnatë dhe do të përfundojë të enjten më 15 nëntor 2007 në mesnatë.

i hedhi në votim të tri propozimet e z. Gashi për heqjen e pikave të rendit të ditës veç e veç, pika të cilat u hoqën nga rendi i ditës me shumicë votash për.<sup>3</sup>

*Kreu 9.1.4 i Kornizës Kushtetuese parasheh që “kohëzgjatja e Kuvendit është tri vjet duke filluar nga dita e seancës së inaugurimit e cila mbahet brenda tridhjetë ditësh pas vërtetimit të rezultatit të zgjedhjeve.” Andaj, kohëzgjatja e Kuvendit është deri më 2 dhjetor meqë seanca inauguruese është mbajtur më 2 dhjetor 2004. Por, rregulla 5.2 e Rregullores së Punës parasheh që Kuvendi ta suspendojë punën e tij që nga dita e parë e fushatës zgjedhore dhe se vetëm Kryesia vazhdon punën për të siguruar vazhdimësinë e Kuvendit, e cila nuk lejon që Kuvendi të mblidhet gjatë apo pas fushatës zgjedhore. Megjithatë, rregulla 61 i jep të drejtë Kuvendit që t’i shmanget dispozitave të Rregullores nëse një shmangie e tillë merr mbështetjen e dy të tretave të deputetëve të pranishëm. Vendimi i Kuvendit për t’ju shmangur rregullës 5.2 është proceduralisht i pajtueshëm meqë ka marrë pikërisht mbështetjen e kërkuar në rregullën 61.*

### Shpërndarja e projektligjeve

- Projektligji për përdorimin e simboleve shtetërore dhe projektligji për inspektoratin e bujqësisë u janë shpërndarë deputetëve më 6 shtator. Projektligji për provimin final dhe të maturës është shpërndarë më 14 shtator. Projektligji për Ministrinë e punëve të jashtme dhe shërbimin diplomatik dhe projektligji për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misionëve diplomatike dhe konzullare dhe stafit të tyre dhe pranisë ushtarake ndërkombëtare janë shpërndarë më 18 shtator. Andaj, projektligjet janë shpërndarë respektivisht 13, tetë dhe gjashtë ditë para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të 27 shtatorit. Projektligji për mbrojtjen e mjedisit është shpërndarë më 3 tetor. Andaj, projektligji është shpërndarë 12 ditë para shqyrtimit të tij të parë në seancën plenare të 18 tetorit. Projektligji për hetimin parlamentar është shpërndarë më 10 tetor. Andaj, projektligji është shpërndarë 12 ditë pune para shqyrtimit të tij të parë në seancën plenare të 30 tetorit.

*Projektligji për përdorimin e simboleve shtetërore, projektligji për inspektoratin e bujqësisë dhe Projektligji për hetimin parlamentar janë shqyrtuar në lexim të parë në pajtim me rregullën 35.1, e cila kërkon që shqyrtimi i parë i projektligjit të bëhet jo më parë se dhjetë ditë pune dhe as më shumë se tri javë pune nga dita e shpërndarjes së tij. Shqyrtimi i parë i projektligjit për provimin final dhe të maturës; Projektligji për Ministrinë e punëve të jashtme dhe shërbimin diplomatik; projektligji për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misionëve diplomatike dhe konzullare dhe stafit të tyre dhe pranisë ushtarake ndërkombëtare; dhe projektligji për mbrojtjen e mjedisit nuk është bërë në pajtim me rregullën në fjalë.*

*Raportet e mëhershme të monitorimit kanë theksuar vështirësitë e Kuvendit në shqyrtimin e projektligjeve brenda afateve të parapara në rregulloren e punës.<sup>4</sup> Është e rekomandueshme për Kuvendin e ardhshëm që ta aplikojë sistemin javor të mbajtjes së seancave plenare ashtu siç ka qenë praktikë gjatë mandatit të parë të Kuvendit, në mënyrë që t’i shqyrtojë projektligjet me kohë dhe efikasitet.*

### Procesi legjislativ

- Projektligji për ndryshimin e ligjit Nr 46/2004 mbi regjistrat e statusit civil dhe projektligji për statusin civil janë miratuar katër muaj pas miratimit të tyre në parim më 31 maj. Projektligji për shoqëritë tregtare është miratuar më shumë se katër muaj pas shqyrtimit të parë më 10 maj. Projektligji për banimin dhe vendqëndrimin është miratuar më shumë se pesë muaj pas shqyrtimit të parë më seancën plenare të 16 marsit. Projektligji për ndryshimin e ligjit Nr 2003/11 për rrugët është miratuar dy muaj pas shqyrtimit të parë më 27 gusht. Projektligji për të

<sup>3</sup> Pika e rendit të ditës për debatin për traktatin e miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ofruar nga Ekipi i Unitetit është hequr nga rendi i ditës me 52 vota për dhe katër vota kundër; pika për pyetjet për Qeverinë është hequr me 39 vota për dhe tetë vota kundër; dhe pika për emërimin e Avokatit të Popullit është hequr me 46 vota për dhe 22 vota kundër.

<sup>4</sup> Shiko raportet 04/2007, 03/2007, 02/2007, 01/2007, 07/2006, 06/2007 dhe 05/2007 të shtyllës së III-të OSBE mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës, pjesën e quajtur “Shpërndarja e projektligjeve”.

drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve të Kuvendit është miratuar shtatë javë pas shqyrtimit të parë më 14 shtator. Projektligji për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik është miratuar më shumë se tre muaj pas shqyrtimit të parë më 12 korrik. Projektligji për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët është miratuar më shumë se katër muaj pas shqyrtimit të parë më 21 qershor.

*Projektligji për ndryshimin e ligjit Nr 2003/11 për rrugët dhe projektligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve të Kuvendit janë procesuar nga Komisionet e Kuvendit në pajtim me rregullën 35.6 e cila parasheh që “Në rastet kur një komision është caktuar ta shqyrtojë projektligjin, atëherë ai i raporton rekomandimet e veta në Kuvend, por jo më vonë se dy (2) muaj nga shqyrtimi i parë i projektligjit, përveç rasteve kur është miratuar një kohëzgjatje shtesë nga Kuvendi.” Sidoqoftë, komisionet i kanë dorëzuar rekomandimet e tyre në projektligjet e mbetura të lartëpërmendura pas kalimit të afatit të paraparë në rregullën 35.6, pa kërkuar nga Kuvendi që ta shtyejë afatin kohor.*

- Në seancën plenare të 27 shtatorit, komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor ka propozuar që projektligji për parqet kombëtare t’i kthehet Qeverisë për shqyrtim të mëtutjeshëm. Në seancën plenare të 30 tetorit/2 nëntorit komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport ka propozuar që projektligji për arsimin privat t’i kthehet Qeverisë, dhe komisioni për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale ka propozuar që tri ligjet në vijim – projektligji për punën, projektligji për grevat dhe projektligji për lirinë e bashkimit në sindikata – t’i kthehen Qeverisë për shqyrtim të mëtutjeshëm.

*Sipas rregullës 35.3 “Propozuesi mund ta tërheqë projektligjin gjatë shqyrtimit të parë deri para fillimit të procedurës së votimit për miratim në parim.” Sipas interpretimit analogjik, Komisionet e lartëpërmendura është dashur t’i propozojnë Kuvendit që t’i kthejnë projektligjet e lartëpërmendura Qeverisë në pajtim me rregullën 35.3. Për më tepër rregulla 35.7 parasheh që “Komisioni funksional - përgjegjës raportues ose kryesor, mund ta shqyrtojë projektligjin në parim edhe para shqyrtimit të parë të projektligjit në seancë plenare.” Sikur Komisionet ta kishin vënë në përdorim rregullën 35.7, do t’i kishin vërejtur më herët të metat e tyre dhe do të kishin mundur t’i kthejnë ato ministrive sponzoruese gjatë leximit të parë në vend se ta bëjnë këtë shumë më vonë. Është tepër e rekomandueshme për mandatin e radhës së Kuvendit që ta shfrytëzojnë mundësinë e shqyrtimit të projektligjeve para leximit të parë në mënyrë që procesi legjislativ të bëhet më i efektiv.*

#### Interpretimi autentik i ligjeve

- Në mbledhjen e mbajtur më 24 shtator, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese ka diskutuar kërkesat e bëra nga Agjensioni Kosovar Kundër Korrupsionit dhe Ministria për transport dhe Komunikacion për interpretim autentik, respektivisht, të dispozitave të ligjit kundër korrupsionit dhe ligjit për prokurim publik. Z. Hajredin Kuçi (PDK) dhe z. Ramadan Kelmendi (LDD) vënë në pikëpyetje kompetencën e komisionit për të dhënë interpretim autentik të ligjeve. Anëtarët e tjerë poashtu shfaqën dyshime në këtë aspekt andaj kjo çështje u shty për mbledhjen e radhës. Në mbledhjen e mbajtur më 10 tetor Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese përsëri e ka diskutuar çështjen e interpretimit autentik të dispozitave të ligjeve të lartëpërmendura, por anëtarët e komisionit sërish shfaqën dyshim lidhur me atë se a është në autoritetin e tyre për ta bërë këtë. Si rezultat, komisioni nuk mundi të vazhdojë më tutje me këtë çështje.

*Rregullorja e Punës nuk përmban dispozita që autorizojnë Komisionin për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese për të bërë interpretimin autentik të ligjeve. E drejta kontinentale ia njeh kompetencën organit legjislativ që të bëjë interpretimin autentik të ligjeve të miratuara, i cili konsiderohet si interpretim zyrtar i ligjit. Por, autorizimi i tillë i organit legjislativ duhet të definohet qartë në formën e normës së shkruar në aktin i cili rregullon punën e organit. Në këtë kontekst, Rregulloret e Punës të Kuvendit të Sllovenisë, Kroacisë, Bosnjë dhe Hercegovinës dhe ish-republikës Jugosllave të Maqedonisë përmbajnë dispozita të cilat në mënyrë të qartë rregullojnë autoritetin e Kuvendit dhe procedurën për interpretimin autentik të*

*ligjeve. I rekomandohet Kuvendit të ardhshëm që ta rregullojë çështjen e interpretimit autentik të ligjeve në Rregulloren e tij të Punës për t'iu shmangur situatave të vështira si ajo më lartë.*

#### Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë

- Në seancën plenare të 27 shtatorit, dy nga gjashtë pyetje kanë marrë përgjigje. Në seancën plenare të 18 tetorit, asnjë nga nëntë pyetjet nuk kanë marrë përgjigje. Në secilën nga seancat plenare nën shqyrtim, Kryetari i Kuvendit apo anëtari i Kryesisë që po kryesonte seancën është përgjigjur se pyetjet që nuk marrin përgjigje brenda dy seancave plenare do të publikohen në buletin e Kuvendit.

*Periudhat e lartëpërmendura të pyetjeve për Qeverinë janë bërë në pajtim me rregullën e ripunuar 26.1 mbi “Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë”, e cila parasheh që rendi i ditës i çdo seance plenare përfshin kohën deri në 50 minuta për pyetjet e deputetëve për Qeverinë, me një minute për pyetjen e deputetit, tri minuta përgjigjen e ministrit, një minutë për pyetjen shtesë dhe dy minuta për përgjigjen në pyetjen shtesë.*

*Sipas rregullës së ripunuar 26.11, “nëse pyetja nuk ka marrë përgjigje brenda dy seancave, ajo publikohet në buletin e Kuvendit.” Por, buletinët e Kuvendit nuk përmbajnë pyetjet që i janë parashtruar Qeverisë, prandaj asnjë pyetje që nuk ka marrë përgjigje nuk është publikuar deri në tetor 2007.<sup>5</sup> Buletini i fundit i Kuvendit që mbulon muajin tetor përmban pyetjet që nuk kanë marrë përgjigje nga marsi deri në tetor 2007.*

#### **4. Qasja**

- Gjatë periudhës raportuese, Shtylla e III-të (OSBE) ka pasur qasje në seancat plenare dhe në mbledhjet e komisioneve. Shtylla e III-të gjithashtu ka pranuar kopjet e dokumentave të shqyrtuara nga Kuvendi si dhe transkriptin e seancave të kaluara.

#### **5. Transparenca**

- Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ka siguruar transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare në fjalë. Publikut dhe monitoruesve institucional iu është mundësuar hyrja në seancat plenare. Kuvendi ka web-faqen ([www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)) që përmban detaje biografike të deputetëve të Kuvendit, informacione për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, kopje të ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi, si dhe informacione të tjera në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

#### **REKOMANDIMET KRYESORE**

- Komisionet e Kuvendit të ardhshëm duhet ta shfrytëzojnë mundësinë e shqyrtimit të projektligjeve para shqyrtimit të tyre të parë, në pajtim me rregullën 35.7, në mënyrë që ta bëjnë procesin legjislativ më të efektshëm.
- Kuvendi i ardhshëm duhet ta rregullojë çështjen e interpretimit autentik të ligjeve në Rregulloren e tij të Punës.

FUND.

---

<sup>5</sup> Shiko raportet 03/2007, 02/2007, 01/2007, 07/2006, 06/2006 dhe 05/2006 të shtyllës III (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës, pjesën e titulluar “Pyetjet për Qeverinë”.